



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 17 tetor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër mbi Caktimin e Datës për Konferencën e Pesëmbëdhjetë për Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 21(6) dhe 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 95 dhe 96 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Kadri Veselit (“z. Veseli”), Rexhep Selimit (“z. Selimi”), dhe Jakup Krasniqit (“z. Krasniqi”) (bashkërisht “Mbrojtja”).²

2. Më 12 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin mbi Kategorizimin e Provave sipas Rregullës 109(c) dhe Çështje të Lidhura me Të, me të cilin urdhëroi kategorizimin e materialit të rregullës 102(1)(b) të kësaj çështjeje gjyqësore dhe shtyu afatin për nxjerrjen e këtij materiali deri më 23 korrik 2021.³

3. Më 24 qershor 2021, në bazë të kërkesës së Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”),⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake shtyu afatet lidhur me materialin e rregullës 102(3).⁵

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, publik; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020, publik. Një version konfidencial me edhe më pak redakte i aktakuzës së konfirmuar u dorëzua më 11 dhjetor 2020, F00134, konfidencial. Pas Vendimit Lidhur me Mangësitë në Formën e Aktakuzës, një version i redaktuar konfidencial, F00455/CONF/RED/A01, dhe një version i redaktuar publik, F00455/RED/A01, i Aktakuzës së Konfirmuar të korigjuar u dorëzuan më 8 shtator 2021. Një version tjetër konfidencial me më pak redakte i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 17 janar 2022, F00647/A01.

³ KSC-BC-2020-06, F00218, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Kategorizimin e Provave sipas Rregullës 109(c) dhe Çështje të Lidhura me Të*, 12 mars 2021, publik, para. 22.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00356, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit për Dhënien e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 18 qershor 2021, publik.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00370, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit për Dhënien e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 24 qershor 2021, publik, para. 16.

4. Më 21 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shtyu afatin për dorëzimin e materialit të rregullës 102(1) deri më 27 shtator 2021.⁶
5. Më 31 korrik 2021, ZPS-ja paraqiti një njoftim të hollësishëm të provave sipas rregullës 102(3) të Rregullores (“Njoftimi sipas Rregullës 102(3)”)⁷.
6. Më 8 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim me të cilin ndryshoi procedurën në lidhje me nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(3).⁸
7. Më 24, 28 dhe 30 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesa të ndryshme për shtyrjen e afatit për nxjerrjen e materialit të rregullës 102(3).⁹
8. Më 18 tetor 2021, pas një kërkesë të ZPS-së,¹⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake pezulloi afatet e ZPS-së në lidhje me materialin e rregullës 102(3).¹¹
9. Më 17 dhjetor 2021, ZPS-ja paraqiti dosjen e saj paraprake dhe materiale të lidhura me të, përfshirë një listë të dëshmitarëve (“Lista e Dëshmitarëve”) dhe një listë të provave materiale (“Lista e Provave Materiale”).¹²

⁶ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 21 Korrik 2021, publik, f. 536, rreshtat 4-9.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00421, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)*, 31 korrik 2021, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Më 22 tetor 2021, ZPS-ja dorëzoi një Njoftim të Ndryshuar, *shih*, F00543, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Ndryshuar i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3) në bazë të Parashtrimit F00421*, publik, me Shtojcat 1 dhe 2, konfidenciale.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00460, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Njoftimit të Rregullës 102(3)*, 8 shtator 2021, publik.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00487, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit*, 24 shtator 2021, publik, para. 14; F00496, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit*, 28 shtator 2021, para. 14; F00499, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit*, 30 shtator 2021, para. 14.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00527, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatje Afati*, 14 tetor 2021, publike.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00528, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje Afati*, 18 tetor 2021, publik.

¹² KSC-BC-2020-06, F00631, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Dosjes Paraprake me Listat e Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale* 17 dhjetor 2021, konfidencial, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Një version i redaktuar publik me Shtojcat e redaktuara konfidenciale 1-3 u dorëzua më 21 dhjetor 2021, F00631/RED. Një version i korrigjuar i dosjes paraprake u dorëzua më 24 shkurt 2022, F00709/A01 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*) dhe F00709/A02 (i redaktuar,

10. Më 28 janar 2022, ZPS-ja dorëzoi Tabelën sipas Rregullës 109(c) .¹³
11. Më 31 janar 2022, ZPS-ja dorëzoi një njoftim me të cilin bëri të ditur se i ka nxjerrë të gjitha materialet e evidentuara më herët si materiale të rregullës 102(1)(b).¹⁴
12. Më 22 prill 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi ndryshimet e bëra në aktakuzë.¹⁵
13. Më 29 prill 2022, ZPS-ja dorëzoi një aktakuzë të ndryshuar dhe dokumentet përkatëse.¹⁶
14. Më 10 maj 2022, u organizuan ndarazi paraqitje të mëtejshme për z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi.¹⁷
15. Më 20 maj 2022, në konferencën e dymbëdhjetë për ecurinë e çështjes, u caktua afati për paraqitjen e dosjeve paraprake të ekipeve të Mbrojtjes më 21 tetor 2022.¹⁸

konfidencial. Lista e provave materiale u ndryshua për herë të fundit më 13 shtator 2022, F00967/A01 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*) dhe F00967/A02 (konfidenciale). Lista e dëshmitarëve u përditësua për herë të fundit më 2 shtator 2022, F00948/A01 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*) dhe F00948/A02 (konfidenciale).

¹³ KSC-BC-2020-06, F00663, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Tabelës sipas Rregullës 109(c)*, 28 janar 2022, publike me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

¹⁴ KSC-BC-2020-06, F00670, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë për Nxjerrje Materiali sipas Rregullës 102(1)(b) dhe Kërkesat në lidhje me Të*, 31 janar 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-9, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Një version i redaktuar konfidencial u dorëzua po atë ditë, F00670/CONF/RED.

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Një version i redaktuar konfidencial u dorëzua po atë ditë, F00777/CONF/RED. Një version i redaktuar publik u dorëzua më 6 maj 2022, F00777/RED.

¹⁶ KSC-BC-2020-06, F00789, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar dhe Dokumenteve Lidhur me Të*, 29 prill 2022, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, Shtojcat 2-4, konfidenciale dhe Shtojcat 5-7, publike.

¹⁷ KSC-BC-2020-06, F00794, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjeve të Mëtejshme dhe Çështje të lidhura me To*, 2 maj 2022, publik, para. 9-13(a). *Shih gjithashtu*, Transkripti i seancës, 10 maj 2022, publik.

¹⁸ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 20 Maj 2022, publik, f. 1324, rreshtat 1-6.

16. Më 30 qershor 2022, në bazë të rregullës 103 të Rregullores, ZPS-ja njoftoi se kishte përfunduar shqyrtimin e materialeve të regjistruara nga 31 janari 2022 deri në 16 qershor 2022.¹⁹

17. Më 8 shtator 2022, në bazë të urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për caktimin e datës së seancës gjyqësore,²⁰ u mbajt konferenca e katërmbëdhjetë për ecurinë e çështjes (“konferenca e katërmbëdhjetë për ecurinë e çështjes”)²¹ në të

¹⁹ KSC-BC-2020-06, F00861, Prokurori i Specializuar, *Kërkesa e Tretë e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse për Materiale që Përbajnë Informacion të Rregullës 103*, 30 qershor 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-9, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

²⁰ KSC-BC-2020-06, F00940, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Katërmbëdhjetë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 30 gusht 2022, publik.

²¹ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 8 shtator 2022, publik. Përpara kësaj u mbajtën në intervale të rregullta trembëdhjetë konferenca për ecurinë e çështjes, konkretisht më 18 nëntor 2020, 17 dhjetor 2020, 16 shkurt 2021, 24 mars 2021, 19 maj 2021, 21 korrik 2021, 14 shtator 2021, 29 tetor 2021, 15 dhjetor 2021, 4 shkurt 2022, 24 mars 2022, 20 Maj 2022 dhe 13 korrik 2022. *Shih*, F00074, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës për Mbajtjen e Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 11 nëntor 2020, publik, para. 21(a), me Shtojcën 1, publik; Transkripti i seancës, 18 Nëntor 2020, publik; F00130, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës për Mbajtjen e Konferencës së Dytë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 8 dhjetor 2020, publik, para. 19(a); Transkripti i seancës, 17 dhjetor 2020, publik; F00185, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Tretë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 3 shkurt 2021, publik, para. 19(a); F00193, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Ndryshimin e Datës së Konferencës së Tretë mbi Ecurinë e Çështjes*, 9 shkurt 2021, publik, para. 2; Transkripti i seancës, 16 shkurt 2021, publik; F00227, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Katërt mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 17 Mars 2021, publik, para. 16(a); Transkripti i seancës, 24 Mars 2021, publik; F00300, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Pestë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 14 maj 2021, publik, para. 19(a); Transkripti i seancës, 19 maj 2021, publik; F00393, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Gjastë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 12 korrik 2021, publik, para. 15(a); Transkripti i seancës, 21 Korrik 2021, publik; F00461, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Shtatë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 8 shtator 2021, publik, para. 15(a); Transkripti i seancës, 14 Shtator 2021, publik; F00531, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Tetë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 18 tetor 2021, publik, para. 18(a); Transkripti i seancës, 29 tetor 2021, publik; F00593, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Nëntë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 2 dhjetor 2021, publik, para. 18(a); Transkripti i seancës, 15 dhjetor 2021, publik; F00655, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dhjetë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 25 janar 2022, publik, para. 19(a); Transkripti i seancës, 4 shkurt 2022, publik; F00734, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Njëmbëdhjetë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 15 mars 2022, publik, para. 21(a); Transkripti i seancës, 24 mars 2022, publik; F00798, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dymbëdhjetë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 12 maj 2022, publik; Transkripti i seancës, 20 maj 2022, publik; F00863, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së*

cilën Mbrojtja u urdhërua: (i) të parashtronte kërkesa për të përligjur nevojën për masa hetimore unike deri më 28 tetor 2022;²² (ii) të paraqiste njoftime për alibi apo arsytet për përjashtimin e përgjegjesisë deri më 28 tetor 2022;²³ dhe (iii) të dorëzonte njoftime në lidhje me kundërshtimet lidhur me pranueshmërinë e materialeve provuese deri më 18 nëntor 2022.²⁴ ZPS-ja u urdhërua të dorëzonte: (i) deri më 28 tetor 2022, një njoftim zyrtar lidhur me kohën se kur parashikohet të hiqet secili prej redaktimeve në aktakuzë sipas sistemit të masave mbrojtëse aktuale²⁵ dhe (ii) një listë provizore të 40 dëshmitarëve të parë që synon të thërrasë deri më 18 nëntor 2022.²⁶ Gjithashtu, palët u urdhëruan të dorëzojnë njoftime lidhur me pikat juridike dhe/ose faktike për të cilat palët pajtohen deri më 18 nëntor 2022.²⁷

18. Më 30 shtator 2022, ZPS-ja paraqiti Tabelën e Përditësuar sipas Rregullës 109(c)²⁸ dhe përfundoi shqyrtimin e kërkesave sipas rregullës 102(3).²⁹ Po atë ditë, u dorëzua një aktakuzë e ndryshuar e konfirmuar me ndryshime të mëtejshme

Konferencës së Trembëdhjetë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve, 1 korrik 2022, publik; Transkripti i seancës, 13 korrik 2022, publik.

²² KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 8 shtator 2022, publik, f. 1582, rreshti 21 deri në f. 1583, rreshti 6.

²³ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 8 shtator 2022, publik, f. 1583, rreshtat 7-13.

²⁴ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 8 shtator 2022, publik, f. 1583, rreshtat 21 deri në f. 1584, rreshti 2.

²⁵ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 8 shtator 2022, publik, f. 1584, rreshtat 3-8.

²⁶ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 8 shtator 2022, publik, f. 1584, rreshtat 9-12.

²⁷ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 8 shtator 2022, publik, f. 1583, rreshtat 14-20.

²⁸ KSC-BC-2020-06, F01000, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Tabelës Plotësuese sipas Rregullës 109(c) nga Prokuroria*, 30 shtator 2022, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

²⁹ KSC-BC-2020-06, F01005, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë për Përmbushjen e Urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 3 tetor 2022, publik.

(“Aktakuza e Ndryshuar më Tej”),³⁰ e cila pasqyronte tërheqjen e disa akuzave³¹ dhe disa shtesa të urdhëruara me qëllim bërjen e aktakuzës më konkrete.³²

19. Më 7 tetor 2022, ZPS-ja dorëzoi Njoftimin e Përditësuar sipas Rregullës 102(3).³³ Gjithashtu, po atë ditë, Mbrojtja e z. Thaçi dha njoftim se do të kërkonte mundësi hetimore unike në përputhje me rregullën 99 të Rregullores.³⁴

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

20. Në bazë të rregullës 96(1) të Rregullores, pas konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thërret konferenca pasuese mbi ecurinë e çështjes, nëse konsiderohet e nevojshme për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, me mbrojtësin e viktimave, për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykim; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes gjyqësore dhe që palëve, e kur është e zbatueshme mbrojtësit të viktimave, t’u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

21. Sipas nenit 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në zotërim të ZPS-së të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit, i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë tij, vetëm me kufizime që janë rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e masave mbrojtëse kompensuese të nevojshme.

³⁰ KSC-BC-2020-06, F00999, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar*, 30 shtator 2022, publik, me Shtojcën 1, e *ex parte*, Shtojcën 2, konfidenciale, dhe Shtojcën 3, publike.

³¹ KSC-BC-2020-06, F00993, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës*, 29 shtator 2022, konfidencial. Një version i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë.

³² KSC-BC-2020-06, F00895, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës së Ndryshuar*, 22 Korrik 2022, publik.

³³ KSC-BC-2020-06, F01021, Prokurori i Specializuar, *Njoftimi Plotësues i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)*, 7 tetor 2022, publik, Shtojca 1, konfidenciale.

³⁴ KSC-BC-2020-06, F01018, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftimi i Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Mundësitë Hetimore Unike*, 7 tetor 2022, publik.

Në bazë të rregullës 102(3) të Rregullores, ZPS-ja i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim.

22. Sipas rregullës 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve të përmendura në rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, fton Mbrojtjen që, brenda një afati të përcaktuar, të dorëzojë dosjen e vet paraprake. Gjithashtu, brenda një afati të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja njofton ZPS-në mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale, ndër të cilat aftësia mendore e kufizuar, intoksikimi, domosdoshmëria, shtrëngimi dhe gabimet faktike apo ligjore.

23. Sipas rregullës 96(2) të Rregullores, me pëlqimin me shkrim të akuzuarit pas këshillimit me mbrojtësin, konferenca mbi ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit, me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit, me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të akuzuarit, në praninë e mbrojtësit ose pjesëmarrjen nëpërmjet videokonferencës. Gjithashtu, çdo kërkesë për pjesëmarrje në konferencën mbi ecurinë e çështjes nëpërmjet videokonferencës i drejtohet drejtpërdrejt Administratores, në përputhje me Udhëzuesin e Punës së Zyrës Administrative për Videolidhjet (KSC-BD-23/COR), dhe në kohë të mjaftueshme paraprakisht në mënyrë që Administratorja të ndërmarrë hapat e duhur, përfshirë informimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.³⁵

III. DISKUTIM

24. Pasi ka marrë parasysh preferencat e shprehura nga palët dhe mbrojtësi i viktimave për datat si dhe disponueshmërinë e sallës së gjyqit, Gjykatësi i Procedurës

³⁵ *Shih gjithashtu, KSC-BC-2020-06, F00062, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim për Autorizim të Pjesëmarrjes përmes Videolidhjes, 6 nëntor 2020, publik, para. 10; F00069, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim mbi Autorizim të përmes Pjesëmarrjes me Videolidhje, 9 nëntor 2020, publik, para. 9.*

Paraprake cakton që konferenca e pesëmbëdhjetë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore të mbahet të premten, 4 nëntor 2022, në orën 13:30.

25. Gjatë seancës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve përditësime, nëse kanë, për pikat ende të pazgjidhura nga konferenca e katërmëdhjetë, dhe për parashtrimet me shkrim dhe me gojë që kanë bërë në lidhje me ato pika. Veçanërisht dhe gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë përditësime në lidhje me pikat në vijim, sipas radhës së përcaktuar më poshtë:

(1) Nxjerrja e materialeve:

- a. Nëse është bërë përparim në procesin e nxjerrjes së materialit në lidhje me materialin e rregullës 107, në veçanti për sasinë e materialit për të cilin ende nuk është marrë autorizimi për nxjerrje dhe nëse priten të bëhen së shpejti kërkesa të tjera sipas kësaj rregulle.

(2) Përkthimi:

- a. Nëse Zyra Administrative mund të japë informacion të përditësuar lidhur me përkthimet e mbetura, në veçanti, përparimin e bërë me përkthimin e Aktakuzës së Ndryshuar më Tej dhe Tabelën sipas Rregullës 109(c) dhe shtesën e saj.

(3) Hetimet e Mbrojtjes dhe hapat e mëtejshëm:

- a. Nëse Mbrojtja mund të japë më shumë informacion për ecurinë e hetimeve të saj, në veçanti, për hapat e ndërmarrë për t'i çuar përpara hetimet e saj;
- b. Nëse është bërë ndonjë përparim në diskutimet mbi pikat juridike dhe/ose faktike për të cilat ka pajtim, në përputhje me rregullat 95(3) dhe 156 të Rregullores, dhe nëse palët parashikojnë ndonjë vështirësi për dorëzimin e njoftimeve përkatëse deri më 18 nëntor 2022; dhe

- c. Nëse Mbrojtja parashikon ndonjë vështirësi në parashtrimin e njoftimeve lidhje me kundërshtimet e saj, nëse ka në këtë fazë të procedurave, për pranueshmërinë e materialit provues të nxjerrë, në përputhje me rregullën 95(2)(e) të Rregullores, deri më 18 nëntor 2022.

(4) Pika të tjera:

- a. Nëse ZPS-ja parashikon ndonjë vështirësi për paraqitjen e listës me 40 dëshmitarët e parë që synon të thërresë deri më 18 nëntor 2022;
- b. Në lidhje me rregullat 153, 154 dhe 155 të Rregullores, konstatohet se ka dëshmitarë që kanë dhënë disa deklaratë; a do të ishte në gjendje ZPS-ja të bëjë të ditur (sipas numrit ERN të dokumenteve) se cilën deklaratë (cilat deklaratë) synon të dorëzojë për t'u pranuar si prova në bazë të këtyre rregullave; dhe
- c. Nëse palët parashikojnë ndonjë vështirësi që kjo çështje gjyqësore t'i kalohet trupit gjykues rreth fundit të vitit dhe nëse palët parashikojnë ndonjë vështirësi sa i takon paraqitjes së tyre para Trupit Gjyqësor pak kohë pasi çështja t'i kalohet Trupit Gjyqësor.

26. Së fundi, palët dhe pjesëmarrësit ftohen të bëjnë të ditur nëse parashikojnë nevojën për mbajtjen e një konference për ecurinë e çështjes në dhjetor, përpara se çështja t'i kalohet Trupit Gjyqësor.

27. Palët dhe pjesëmarrësit ftohen të dorëzojnë parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë, për secilën nga pikat më lart. Nëse palët dhe pjesëmarrësit dëshirojnë që gjatë konferencës së ardhshme për ecurinë e çështjes të ngrenë ndonjë çështje shtesë që nuk përfshihet në këtë urdhër, përfshirë vështirësi me *Legal Workflow* ose përkthimet, ftohen t'i përfshijnë këto çështje në parashtrimet e tyre me shkrim. Palët dhe pjesëmarrësit ftohen t'i dorëzojnë këto parashtrime të hënën, më 31 tetor 2022.

IV. VENDIM

28. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **VENDOS** të mbajë konferencën mbi ecurinë e çështjes në prani të ZPS-së, mbrojtësit të viktimave dhe Mbrojtjes, **të premten, më 4 nëntor 2022**; dhe
- b. **U KËRKON** palëve dhe pjesëmarrësve të dorëzojnë parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë, **të hënë, më 31 tetor 2022**, sikundër përcaktohet në paragrafin 27 më lart.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 17 tetor 2022

Në Hagë, Holandë.